

VENDIM
Nr.623, datë 7.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “BATRA NR. 1, NR. 2 DHE NR. 3”, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË
I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Batra nr.1, nr.2 dhe nr.3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënien me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “KEA” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Batra nr.1, nr.2 dhe nr.3” të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha